



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 3412/ 9 prot.,

Datë 12 /02/2025

V E N D I M
Nr. 231 /2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 12 /02/2024 shqyrtoi ankesën me:

Objekti:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “ADD Group” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur e thjeshtuar*” me nr. REF-24856-10-16-2024, me objekt: “Loti II-të: Blerje printera”, me fond limit: 1,020,317.00 Lekë *pa TVSH*, zhvilluar më datë 04.11.2024 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kamëz.

Ankimues:

Operatori ekonomik “Erisoni Company”, me Nipt K92006501A me adresë: *Lagjja 6, Rruga “Shoqëria Bashkimi”, Pallati Clas, Kati i parë, Durrës.*

Autoriteti Kontraktor:

Bashkia Kamëz
Bulevardi “Nënë Tereza” nr.492 Kamëz Tiranë

Subjekte të Interesuara:

“ADD Group” SHPK, me NIPT L81722022V. me adresë: *Kamëz, Rruga “Bulevardi Nënë Tereza”, Bashkia Kamëz, Nr. pasurie 9/22 dhe ZK 2066.*

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.

285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr.766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt - ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me nenin 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 17-10-2024 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, me nr. REF-24856-10-16-2024, me objekt: “Loti II-të: Blerje printera”, me fond limit: 1,020,317.00 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 04.11.2024 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kamëz.

II.2 Në datën 13.11.2024 është bërë klasifikimi i operatorëve ekonomikë pjesëmarrës, duke i njoftuar me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të ofertave ekonomike për vlerat (pa TVSH) si më poshtë:

“ADD GROUP” shpk	788.900,00	lekë	kualifikuar
“Erisoni Company” shpk	795.000,00	lekë	kualifikuar
“COLOMBO” shpk	967.000,00	lekë	skualifikuar

II.3. Në datën 14.11.2024 Autoriteti Kontraktor ka publikuar Njoftim fituesin paraprak sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.).

II.4. Nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik si edhe pranë Autoritetit Kontraktor, është depozituar ankesa me numër ankimimi A/2024/4811, datë 19.11.2024 dhe me nr. 3412/2024 Prot., dhe protokolluar me datë 20.11.2024 e operatorit ekonomik “Erisoni Company” SHPK, duke kundërshtuar vendimin e KVO-së mbi kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “ADD Group” SHPK .

II.5 Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe me anë të formularit të publikimit nr. 3412/2 prot., datë 21.11.2024, janë publikuar pretendimet e operatorit ekonomik ankimues në lidhje me arsyet e kualifikimit të ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “ADD Group” SHPK.

II.6 Më datë 05.12.2024 me protokolluar me tonën me nr. 3412/3 nga Bashkia Kamëz, nëpërmjet shkresës me nr. 10144/1, datë 02.12.2024, me objekt “*Shkresë përcjellëse*”, në lidhje me vlerësimin ankesës së paraqitur nga operatorit ekonomik “Erisoni Company” SHPK , për procedurën objekt – ankimi, rezulton se nuk e ka pranuar ankesën e paraqitur.

II.7 Më datë 17.12.2024 më shkresën me nr. 3412/4 prot., me objekt “Kërkesë për informacion” Komisioni i prokurimit publik i është drejtuar operatorit ekonomik “ADD Group” shpk në lidhje me evidentimin e markimit të katalogëve të dorëzuar në SPE.

II.8 Me datë 07.02.2025 me shkresën nr.3412/5 me lëndë “Njoftim” publik, drejtuar operatorit ekonomik “Add Group” shpk në lidhje me informacionin e kërkuar me shkresën nr. 3412/4 datë 17.12.2024.

II.9 Me datë 11.02.2025 protokolluar me tonën nr. 3412 Prot., operatori ekonomik ADD Group shpk ka depozituar pranë Komisionit të prokurimit publik shkresën me lëndë “Kthim përgjigje” ku në përmbajtje të shkresës operatori ekonomik ka përcjellë dokumentacionin kopje “Katalog teknik” .

II.10. Nga verifikimet e kryera, rezulton, se nuk janë paraqitur pranë Komisionit të Prokurimit Publik argumente nga subjekte të interesuara lidhur me ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Erisoni Company”, SHPK sipas parashikimeve të nenit 113 të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”.

III Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor.

Arsyeton

III.1 Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Erisoni Company ”SHPK, mbi vendimin e KVO-së për kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “ADD Group ” SHPK me arsyet se:

“Pretendimi 1: Në kriteret e vecanta te kualifikimit enti prokurues ka vendosur kriterin kualifikues si me poshte: a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9 Pretendojme qe OE ADD GROUP ka përdorur tjetër formular vetëdeklarimi nga ai i publikuar nga autoriteti kontraktor në setin e dokumenteve standarde të procedurës së prokurimit. Dyshojme se Formulari i vetëdeklarimit i ngarkuar nga operatori ekonomikë në sistemin e prokurimeve elektronike ka ndryshime si në formë, por dhe në përmbajtje që është më e rëndësishmja.

Pretendimi 2: Ne kriteret e vecanta te kualifikimit enti prokurues ka vendosur kriterin kualifikues si me poshte: b.Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3; Pretendojme qe ky operator ekonomik nuk ka dorezuar sigurimin e ofertes sipas shtojces 3.

Pretendimi 3: Ne kriteret e vecanta te kualifikimit pika 2.2.2 enti prokurues ka vendosur kriterin kualifikues si me poshte: Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2023 ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar per vitin 2024 sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 i Për sistemin e taksave vendore, (i ndryshuar). Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, cdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotesimin e formularit te vetedeklarimit, dokumentet perkatese vertetuese do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit). Pretendojme se operatori ekonomik nuk ka dorëzuar dokumentacionin, vërtetime që janë likuiduar taksat dhe tarifat vendore për secilën adresë të ushtrimit të aktivitetit pranë AK

Pretendimi 4: Ne kriteret e vecanta te kualifikimit pika 2.2.3 enti prokurues ka vendosur kriterin kualifikues si me poshte: Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë për periudhën e garancisë së artikujve (jo më pak se 1 vit), gjatë secilës ofertuesi do të sigurojë riparimin dhe mirëmbajtjen e tyre.

Pretendojme qe ky operator ekonomik nuk ka dorezuar deklaraten per periudhen e garancise se artikujve ,objekt prokurimi. 1.Per Printer B&E Standard Periudha e Mbulimit të Garancisë Eëarranty: 2 Vjet 2.Per Skaner Tipi 3 Periudha e Mbulimit të Garancisë Eëarranty: 3 Vjet 3.Per Fotokopje Multifunction B&E Copy Machine A4 Periudha e Mbulimit të Garancisë Eëarranty: 1 Vit ose 150 000 Kopje* 4. Per Fotokopje Multifunction High Volume Copy Machine Periudha e Mbulimit të Garancisë Eëarranty: 3 Vjet ose 600 000 Kopje*

Pretendimi 5: Ne kriteret e vecanta te kualifikimit pika 2.3.4 enti prokurues ka vendosur kriterin kualifikues si me poshte: Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë(në mënyrë elektronike, në sistemin e APP-së) katalog për mallrat që ofertontë përkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuar, në mënyrë që të vërtetohet përputhja me specifikimet teknike të dokumentave të tenderit të autoritetit kontraktor.

Në katalog duhet të markohet secili nga artikujt e ofertuar. Specifikimet teknike te modifikuara sipas shtojces te dates 24.10.2024 nga Autoriteti Kontraktor Bashkia Kamez.

Specifikimet BEHEN si me poshte: Printer B&E Standard KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE Shpejtësia e Printimit i Print Speed A4:= 35 ppm Cikli Mujor i Punës Monthly Duty Cycle: 20 000 Faqe Teknologjia Technology: Laser Rezolucioni i Printimit Minimal iPrint Quality: 1200x600 dpi Kapaciteti në Hyrje Input Capacity: 250 Fletë Pesha Specifike e Letrës Media Sizes: 60-120 g/m? Formati i Letrës Media formati: A4/A5/Envelope Aftësia e Printimit Duplex: Po Memorja Memory: = 256 MB Toner: Shoqëruar me Starter Kit KOMUNIKIMI & MENAXHIMI Porta e Komunikimit Interface: High Speed USB 2.0 Ethernet: Po AKSESORAT Kabëll Poëer Cordi: Po, European Softëare/Drivers CD: Po Kabell USB: Po GARANCIA Periudha e Mbulimit të Garancise eëarranty: 2 Vjet Pjesët e konsumueshme janë drum-i dhe toneri Skaner Tipi 3 karakteristika minimale teknike Tipi iType: CCD ose CIS ose Ekuivalente Cikli Mujor i Punës Monthly Duty Cycle: 6000 Flete/ dite Formati gjeresi - gjatesi Format Size: Gjeresia 50-216mm- Gjatesia 54-356 mm Rezolucioni i Skanimit Scanning Resolutioni 600 dpi Mënyra e Skanimit Scan Mode: Simplex dhe Duplex Vendosja e Materialit iMedia Feeder Type: ADF Kapaciteti i ADF ADF Capacity: 82 Fletë Shpejtësia e Skanimit Scanning Speed: 45 ppm / 90 ipm (300 dpi) Ushqimi iPoëer Supply: 220 V AC, 50 Hz Funksionet iFunctions: TIFF, JPEG, PNG, PDF, PDF/A KOMUNIKIMI & MENAXHIMI Porta e Komunikimit i Interface: Netëork Destinacionet e skanimit Scan to Shared Folder Scan to E-mail Scan to FTP Scan to Printer (FTP printing) Scan to USB Memory iDrivers + OCR Softëare: Po AKSESORAT Ushqyes + Kabëll iPoëer Supply + Cord: Po, European CD/DVD Drivers and Softëare: Po GARANCIA Periudha e Mbulimit tË GarancisË Eëarranty: 3 Vjet Fotokopje Multifunction B&E Copy Machine A4 KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE iModel: Copier/Printer ShpejtËsia iCopy/Print Speed for A4: = 40 ppm Cikli Mujor i Punes Monthly Duty Cycle: = 140 000 Faqe Teknologjia iTechnology: Laser B&E Zvogëlim/Zmadhim iReduction/Enlargement: 25%-400% Vendosja e Dokumentit iDocument Feeder: ADF SirtarËt për Letrën Paper Trays: 2 Kapaciteti në Hyrje iInput Capacity min: 1000 Fletë Kapaciteti nË Dalje Output Capacity min Standard: 100 Fletë Kopjim/Printim në të dy Faqet Duplex Copying/Print.: Po Formati i Letrës Media Sizes: A4 Memorja Memory: 1 GB iHard Disk: 80 GB Shpejtësia e Skanimit iScan Speed: Nuk Specifikohet Rezolucioni i Skanimit Scan Resolution: Nuk Specifikohet Formati i Skanimit Maksimal Maximum Scan Size: Nuk Specifikohet Toner: Shoqëruar me Starter Kit KOMUNIKIMI & MENAXHIMI Porta e Komunikimit Interface: High Speed USB 2.0 Ethernet: Po AKSESORAT Kabëll Poëer Cordi: Po, European Softëare/Drivers CD : Po Kabëll USB: Po

GARANCIA Periudha e Mbulimit të Garancisë ëarranty: 1 Vit ose 150 000 Kopje* *Kush të arrihet më parë Pjesët e konsumueshme janë drum-i dhe toneri. Fotokopje Multifunction High Volume Copy Machine KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE Model: Copier, Printer, Scanner Shpejtësia Copy/Print Speed for A4 ë: = 60 ppm Cikli Mujor i Punës Monthly Duty Cycle: 200 000 Faqe Teknologjia Technology: Laser Color Zvogëlim/Zmadhim Reduction/Enlargement: 25%-400% Vendosja e Dokumentit Document Feeder: RADF/DADF Sirtarët për Letrën Paper Trays: 4 (pa përfshirë Bypassin) Kapaciteti në Hyrje Input Capacity min: 2000 Fletë (jo Bypass-i) Kapaciteti në Dalje Output Capacity mini: 1000 Flet, me Sorter me Stapler Kopjim/Printim në të dy Faqet iDuplex Copying/Print: Po Formati i Letrës Media Sizes: A3/A4 Memorja Memory: = 4 GB Hard Disk: = 250 GB Shpejtësia e Skanimit Scan Speed: = 60 ppm Rezolucioni i Printimit iPrint Resolution: 1200 x 1200 dpi Formati i Skanimit Maksimal Maximum Scan Size: A3 Pesha e letres që suporton Bypass 52-300 g /m2) Toner: Shoqëruar me Starter Kit KOMUNIKIMI & MENAXHIMI Porta e Komunikimit Interface: High Speed USB 2.0 Ethernet: Po Aksesoret Kabëll Poëer Cord: Po, European Software/Drivers CD : Po GARANCIA Periudha e Mbulimit të Garancisë ëarranty: 3 Vjet ose 600 000 Kopje* *Kush të arrihet më parë Pjesët e konsumueshme janë drum-i dhe toneri. Pretendojme se operatori ekonomik ADD GROUP ka ofertuar pajisjet ,objekt prokurimi që nuk plotesojnë specifikimet e mesipërme të vendosura nga autoriteti kontraktor. Mendojme që kataloget që ka dorëzuar ky operator nuk plotesojnë specifikimet e lartpërmendura. Pretendojme që për pajisjen Fotokopje Multifunction High Volume Copy Machine e ka ofertuar pa finisher të jashtëm ,nuk ploteson ; Kapaciteti në Dalje Output Capacity min: 1000 Fletë, me Sorter me Stapler

Pretendimi 6: Duke qenë se klasifikimi u publikua në datën 13.11.2024 ora 15.40 dhe njoftimi i fituesit u publikua në datën 14.11.2024 ora 11.26, **dyshojmë** se OE ADD Group nuk ka përmbushur nenin 26 të VKM 285 datë 19.05.2021 Rregullat e prokurimit publik në lidhje me kërkesën e AK për dorëzimin fizikisht në AK të dokumentacionit sipas formularit përmbledhës të vetëdeklarimit dhe dokumenteve të tjera shoqëruese të ofertës”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1 Autoriteti kontraktor në shtojcën 4,6 ,7 dhe 9, të dokumenteve standarte të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi ka parashikuar kriteret si më poshtë:

Shtojca 4.

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

* * *

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-së.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmbyshjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 6

Fotokopje Multifunction High Volume Copy Machine

KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE	
“Model”:	Copier, Printer, Scanner
Shpejtësia “Copy/Print Speed for A4”:	≥ 55 ppm
Cikli Mujor i Punës “Monthly Duty Cycle”:	200 000 Faqe
Teknologjia “Technology”:	Laser Color
Zvogëlim/Zmadhim “Reduction/Enlargement”:	25%-400%
Vendosja e Dokumentit “Document Feeder”:	RADF/DADF
Sirtarët për Letrën “Paper Trays”:	4 (përfshirë Bypass-i)
Kapaciteti në Hyrje “Input Capacity min”:	2000 Fletë (jo Bypass-i)

Shtojca 7

2.2.2. Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2023 ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar për vitin 2024 sipas përcaktimeve

të Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, (i ndryshuar). Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB. *(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotesimin e formularit të vetedeklarimit, dokumentet perkatese vertetuese do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit).*

2.3.3. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë për periudhën e garancisë së artikujve (jo më pak se 1 vit), gjatë së cilës ofertuesi do të sigurojë riparimin dhe mirëmbajtjen e tyre.

2.3.4 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë (në mënyrë elektronike, në sistemin e APP-së) katalog për mallrat që ofertontë përkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuar, në mënyrë që të vërtetohet përputhja me specifikimet teknike të dokumentave të tenderit të autoritetit kontraktor. Në katalog duhet të markohet secili nga artikujt e ofertuar.

Shtojca 9.

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigjja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	-----
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	-----
E-mail:	-----

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- **Informacione për nënkontraktorin**

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT –i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t’u nënkontraktuar

• I
n
f
o

Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata
Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv. <i>Sqarime</i> <i>nëse</i> <i>vlerësohet</i> <i>e</i> <i>nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së. <i>Sqarime</i> <i>nëse</i> <i>vlerësohet</i> <i>e</i> <i>nevojshme</i> _____
Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:

etj.				
nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.				
<i>Sqarime</i>	<i>nëse</i>	<i>vlerësohet</i>	<i>e</i>	<i>nevojshme</i>
Operatori ekonomik nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi.				
<i>Sqarime</i>	<i>nëse</i>	<i>vlerësohet</i>	<i>e</i>	<i>nevojshme</i>
Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).				
<i>Sqarime</i>	<i>nëse</i>	<i>vlerësohet</i>	<i>e</i>	<i>nevojshme</i>
Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së.				
<i>Sqarime</i>	<i>nëse</i>	<i>vlerësohet</i>	<i>e</i>	<i>nevojshme</i>
Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.				
Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.				
<i>Sqarime</i>	<i>nëse</i>	<i>vlerësohet</i>	<i>e</i>	<i>nevojshme</i>
Operatori Ekonomik nuk ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate.				
<i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i>				

Operatori ekonomik ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.				
<i>Sqarime</i>	<i>nëse</i>	<i>vlerësohet</i>	<i>e</i>	<i>nevojshme</i>
Operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë.				
<i>Sqarime</i>	<i>nëse</i>	<i>vlerësohet</i>	<i>e</i>	<i>nevojshme</i>
Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së. Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.				
<i>Sqarime</i>	<i>nëse</i>	<i>vlerësohet</i>	<i>e</i>	<i>nevojshme</i>
Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi. <i>Sqarime nëse vlerësohet e</i> <i>nevojshme</i> _____				

B: DEKLARATA

Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura

Në cilësinë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik, **Deklaroj Se:**

Jam në dijeni të pasojave që vinë ndaj meje lidhur me këtë Deklaratë, në respektim të ligjit nr. 9121/2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar.

Kam përgatitur ofertën në mënyrë të pavarur, pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër¹.

¹ Për qëllim të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, fjala “konkurrentë” nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, të ndryshëm nga Ofertuesi, të paraqitur ose jo si bashkim operatorësh ekonomik, që: a) paraqesin një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë, të bërë nga Autoriteti Kontraktor; b) është një ofertues i mundshëm, i cili bazuar në kualifikimin, aftësitë ose përvojat e tij, mundet të dorëzojë një ofertë në përgjigje, të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë.

Në veçanti, pa kufizuar si më lart, nuk kam pasur kontratë apo marrëveshje me ndonjë konkurrent me qëllim cënimin e konkurrencën, në lidhje me:

- a) çmimet;
- b) metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;
- c) qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë; ose,
- d) paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për ofertë.

Nuk kam pasur marrëveshje apo kontrata me ndonjë konkurrent, me qëllim cënimin e konkurrencës, në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet apo dërgesa të veçanta të produkteve apo shërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë.

Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të njohura dhe as nuk do t'u bëhen të njohura, me qëllim cënimin e konkurrencës, në çdo mënyrë qoftë, konkurrentëve të tjerë, para datës dhe kohës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes fitues dhe lidhjes së kontratës, vetëm nëse kërkohet me ligj.

C: DEKLARATA

Mbi Konfliktin e Interesit

Deklarata

Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se jemi të vetëdijshëm për sa vijon:
Konflikti i interesit është një situatë e konfliktit midis detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari, në të cilën ai / ajo ka interesa private direkte ose indirekte që ndikojnë, ose që mund të ndikojë ose që duket se ndikojnë në kryerjen e padrejtë të detyrave dhe detyrimeve publike.

Në përputhje me nenin 21, paragrafi 1, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve siç parashikohen në Kapitullin III, Seksioni II, që janë absolutisht të ndaluara të përfitojnë drejtpërdrejt ose indirekt nga nënshkrimi i kontratave midis një pale dhe institucionit publik janë:

- Presidenti i Republikës, Kryeministri, Zëvendës Kryeministri, Ministrat, ose Zëvendësministrat, Deputetët, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kreu i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët dhe Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Gjykatës së Apelit, Avokati i Popullit, Anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, Anëtarët e Enteve Rregullatore (Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zëvendësguvernatorin; konkurrenca; telekomunikacioni; energjia elektrike; furnizimi me ujë; sigurimi; bonot; autoritetet e medias), sekretarët e përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar publik në çdo institucion publik pozicioni i të cilit është i barabartë me atë të Drejtorit i Përgjithshëm, drejtuesit e organeve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil.

Për nëpunësit civilë të nivelit të mesëm, sipas nenit 31 dhe zyrtarët sipas nenit 32 të kreut III, seksionit 2 të këtij ligji, ndalimi në paragrafin 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, siç përcaktohet këtu të zbatohet vetëm në rast të lidhjes së kontratave brenda fushës dhe territorit të institucionit dhe juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim do të zbatohet edhe kur pala në kontratë është një institucion varësie.

Kur zyrtari është kryetar bashkie ose nënkryetar i një bashkie ose komune, ose kryetar i një këshilli rajonal, anëtar i këshillit përkatës, ose një zyrtar i lartë i menaxhimit të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave private të zyrtarit, specifikuar këtu, do të zbatohet vetëm në rastin e lidhjes së kontratave, nëse ka, me bashkinë, komunën ose rajonin ku zyrtari ushtron një detyrë të tillë. Ky ndalim do të zbatohet gjithashtu kur pala në kontratë është një institucion publik në varësi të kësaj njësie (neni 21, paragrafi 2, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005).

Ndalimet e parashikuara në nenin 21, paragrafët 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, do të zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin, d.m.th. **bashkëshortin, bashkëjetuesin, fëmijët madhorë e prindërit e zyrtarit dhe të bashkëshortit dhe bashkëjetuesit.**

Unë jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të parashikuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksioneve Publike", të ndryshuar, dhe aktet nënligjore të miratuara në bazë të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimi dhe Kontrolli i Pasurive, si dhe Ligji Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik".

Në përputhje me to, unë deklaroj këtu se asnjë zyrtar publik, siç përcaktohet në Kapitullin III, Seksioni II të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk ka ndonjë interes privat, direkt ose indirekt, me personin juridik që unë përfaqësoj këtu.

D: DEKLARATA

Për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës

Deklarata

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Operatori ekonomik _____garanton mbrojtjen e të drejtës së punësimit dhe profesionit nga çdo formë diskriminimi, të parashikuar nga legjislacioni i punës në fuqi.
- Operatori ekonomik_____lidh me punëmarrësit kontratat përkatëse të punës dhe garanton masat në drejtim të sigurisë dhe shëndetit në punë për të Gjithë dhe, në mënyrë të veçantë, për grupet e rrezikuara, bazuar në legjislacionin e punës në fuqi.
- Operatori ekonomik _____nuk ka masë Ligjore në fuqi, të vendosur nga Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH). Në rastet kur janë konstatuar shkelje ligjore, operatori ekonomik ka marrë masat e nevojshme për adresimin e tyre, brenda afateve të përcaktuara nga ISHPSHSH.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme

Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit

A: DEKLARATË

Në përputhje me specifikimet teknike dhe grafikun e realizimit të objektit të kontratës:

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se plotësojnë të gjitha specifikimet teknike, siç udhëzohet në dokumentet e tenderit, dhe këtë e provojmë përmes certifikatave dhe dokumenteve të paraqitura me këtë deklaratë (nëse kërkohet nga Autoriteti Kontraktor), dhe marrim përsipër të realizojmë objektin në përputhje me Listën e mallrave dhe grafikun e lëvrimit të përcaktuar nga Autoriteti kontraktor.	Po [] Jo []

B: DEKLARATË

Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se: Unë kam punonjës të nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me	<u>Punonjës</u> Po [] Jo [] Nëse, po, numri i punonjësve: Profili i punonjësve

dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.	<u>Makineri e mjete</u> Po [] Jo [] Nëse po, të listohen me të dhënat konkrete:
Emri, Mbiemri _____ Firma _____ Vula _____ Data e dorëzimit të deklaratës _____	

III.1.2. Në nenin 77, pikat 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”

III.1.3. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pikat 1, 2, 3, 6 dhe 7 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla. 2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarimin, si më poshtë vijon: 15 a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv; b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së; c)

personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së; ç) operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale; d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi; dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve 1 të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së; e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohej për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë; ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi; f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës; g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi; gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor; h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti); i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti; j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti; k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi. 3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash. 4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm. 5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohej të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente. 6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si 16 dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin. Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike. Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj. Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur. 7. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t’i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

III.1.4. Në nenin 2 “Qëllimi i ligjit” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se: Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet 15 procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

III.1.5. Në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se 1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutë

III.1.6. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës. Një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai i barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 2 dhe 3 i ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar . Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garanci kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur vlerësohen ato. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente, duhet të refuzohen si të papranueshme. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt-prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës i plotësojnë të gjitha kriteret kualifikues në përputhje me kërkesat e AK si në përmbajtjen e tyre edhe në formën e rregullt të përcaktuar.

III.1.6. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Erisony Company” shpk ku ngre pretendimin si në vijim: *“Pretendimi 1: Ne kriteret e vecanta te kualifikimit enti prokurues ka vendosur kriterin kualifikues si me poshte: a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9 Pretendojme qe OE “ADD GROUP”SHPK ka përdorur tjetër formular vetëdeklarimi nga ai i publikuar nga autoriteti kontraktor në setin e dokumenteve standarde të procedurës së prokurimit. Dyshojme se Formulari i vetëdeklarimit i ngarkuar nga operatori ekonomikë në sistemin e prokurimeve elektronike ka ndryshime si në formë ,por dhe në përmbajtje që është më e rëndësishmja...*

Nga verifikimeve të kryera në shtojcën 9 pjesë e dokumentave standarte të tenderit si dhe si dhe gjithashtu referuar dokumentacionit të ngarkuar në SPE nga operatori ekonomik “ADD Group” SHPK, Komisioni konstaton, se Shtojca 9 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit” rezulton i ngarkuar në sistem si pjesë e ofertës së OE, si dhe gjithashtu rezulton i plotësuar me informacione të kërkuar në të gjitha rubrikat e tij si dhe i nënshkruar, vulosur nga operatori ekonomik.

Referuar fakteve sa më sipër analizuar, Komisioni i Prokurimit Publik sqaron, se Formulari përmbledhës i vetdeklarimit i ngarkuar nga operatori ekonomik në sistemin e prokurimeve elektronike nuk ka ndryshime në formë apo dhe në përmbajtje e cila është më e rëndësishmja. Në rastin konkret, pretendimi i operatori ekonomik ankimues nuk qëndron pasi ofertuesi “ADD Group” shpk ka ofertuar sipas shtojcës 9 “Formulari Përmbledhës i Vetdeklarimit” pjesë e dokumentave standarte të tenderit si dhe për më tepër forma e tij dhe përmbajtja janë konform kërkesave që ka parashikuar ligji sektorial.

Gjithashtu KPP sjell në vëmendje operatorit ekonomik ankimues se një ankim në total, pa argumente të arsyeshme apo indicie të qarta, mbi të gjithë apo shumicën e elementeve përbërëse të ofertës së konkurrentit/konkurrentëve të kualifikuar përpara tij ose të barabartë me të në ofertë ekonomike, do të konsiderohet abuziv, në kundërshtim me qëllimin e veprimtarisë së Komisionit, pasi cënon efikasitetin dhe shpejtësinë e procedurës së prokurimit publik dhe krijon mbi të gjitha artifice për realizimin e procedurave të prokurimit.

Referuar parashikimeve të nenit 82 Barra e provës “Kodi i procedurës administrative i Shqipërisë”: *1. Në procedurat administrative, të filluara me kërkesë të palës që inicion procedurën, barra e provës për faktet e pretenduara bie mbi këtë palë, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj...*

Gjithashtu referuar pikës 2 neni 111 të LPP nr.162/2020 parashikon se, 2. Ankesa bëhet sipas formularit përkatës, ku shënohen emri dhe adresa e ankuesit, referimi për procedurën konkrete dhe bazën ligjore, ku ankuesi pretendon për shkeljet, pagesa e tarifës së ankesës, duke e shoqëruar atë me dokumentacionin dhe provat përkatëse, për të cilat mendon se mbështesin ankimin e tij. Elementet e sipërpërmendura janë të domosdoshme për shqyrtimin e ankesës...

Ankesa, sipas rastit, mund të shoqërohet edhe me: a) provat dokumentare, të cilat ankimuesi kërkon të shqyrtohen nga Komisioni.

Përsa më sipër operatori ekonomik ka detyrimin që ta bëjë të identifikueshëm pretendimin e tij mbi shkeljen e pretenduar, pra të evidentojë qartë dhe saktë se ku e bazon pretendimin e tij për mospërmbushjen e kriterit/kritereve nga ana e operatorëve ekonomikë të tjerë. Theksojmë se mospërmbushja e kriterit apo kushteve të vendosura nga autoriteti kontraktor mund të vijë për shkaqe të ndryshme, siç janë mosparaqitja e një dokumenti të kërkuar, ose problematika që mund të prekin dokumentin etj. Është barrë e operatorit ekonomik që të përcaktojë se në cilin fakt apo rrethanë e mbështet pretendimin e tij për mospërmbushje kriteri/kriteresh, ndaj dhe pretendimet e operatorit ekonomik “Erisoni Company” sh.p.k përsa i përket operatorit ekonomik “ADD Group” sh.p.k nuk do të merren në shqyrtim nga KPP.

Për sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.1.7 Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Erisony Company ” SHPK me arsyetimin se: *“Në kriteret e vecanta te kualifikimit enti prokurues ka vendosur kriterin kualifikues si me poshte: b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3; Pretendojme qe ky operator ekonomik nuk ka dorezuar sigurimin e ofertes sipas shtojces 3.”* ... Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson se, referuar shtojcës së dokumentave standarte të tenderit si dhe dokumentacionit të ngarkuar në SPE nga operatori ekonomik “ADD Group” SHPK rezulton se nga verifikimet e kryera në sistemin elektronik operatori ekonomik ka ngarkuar formularin e sigurimit të ofertës konkretisht me të dhënat si në vijim...*me numër serial 240608701; K42108801C; datë 04.11.2024;... për Autoritetin kontraktor Bashkia Kamëz, në emër të “ADD Group”shpk; me NIPT L81722022V; Procedura e prokurimit e hapur e thjeshtuar; LOTI II: Blerje Printera; me nr. Ref-24856-10-06-2024.*

Për sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.1.8. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Erisony Company ” shpk me arsyetimin se: *Pretendojmë se operatori ekonomik nuk ka dorëzuar dokumentacionin, vërtetime që janë likuiduar taksat dhe tarifat vendore për secilën adresë të ushtrimit të aktivitetit pranë AK , Komisioni vlerëson se referuar pretendimit, dokumëntave standarte të tenderit si dhe gjithashtu dokumentacionit të ngarkuar në SPE,rezulton se referuar kriterit të kërkuar në dst pika 2.2.2. Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2023, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar per vitin 2024 ...*

III.1.9 Komisioni prokuimit publik konstaton se autoriteti kontraktor në pikën 2.2.2. të dokumentave standarte të tenderit ka parashikuar: “Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin **2023**, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar per vitin **2024** sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, (i ndryshuar). Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB.

III.1. 10 Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson se, referuar shtojcës së dokumentave standarte të tenderit si dhe dokumentacionit të ngarkuar në SPE nga operatori ekonomik “ADD Group” SHPK rezulton se nga verifikimet e kryera në sistemin elektronik operatori ekonomik ka ngarkuar në SPE “Vërtetim për likuidim e detyrimeve vendore” me datë 17.05.2024 me të dhënat si më poshtë:

Nr. _____ prot.

Tiranë, më 12/12/2023

VËRTETIM PËR LIKUJDIMIN E DETYRIMEVE VENDORE

TAKSA PAGUESI NR.	148549
SUBJEKTI FIZIK/JURIDIK	ADD PRINT
ADMINISTRATORI	ADENIS KASTRATI
FORMA JURIDIKE	Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar
NIPTI	L81722022V
ADRESA	Rruga "Spiro Fllloqi", Pallatet "Ajazi", Kati i Parë, Nr.3, Njësia Administra

Vërtetojmë se, subjekti ka likujduar detyrimet vendore, të parashikuara sipas Ligjit Nr. 9632 datë, 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore" me ndryshimet përkatëse, si dhe në Vendimin e Këshillit Bashkiak Nr. 158, datë 26.12.2019 "Për Sistemin e Taksave dhe Tarifave Vendore në Qytetin e Tiranës" me ndryshimet përkatëse.

Ky vërtetim lëshohet për efekt dokumentacioni (tender).

Nr. _____ prot.

Tiranë, më 17/05/2024

VËRTETIM PËR LIKUJDIMIN E DETYRIMEVE VENDORE

TAKSA PAGUESI NR.	148549
SUBJEKTI FIZIK/JURIDIK	ADD PRINT
ADMINISTRATORI	ADENIS KASTRATI
FORMA JURIDIKE	Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar
NIPTI	L81722022V
ADRESA	Rruga "Spiro Fllloqi", Pallatet "Ajazi", Kati i Parë, Nr.3, Njësia Administra

Vërtetojmë se, subjekti ka likujduar detyrimet vendore, të parashikuara sipas Ligjit Nr. 9632 datë, 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore" me ndryshimet përkatëse, si dhe në Vendimin e Këshillit Bashkiak Nr. 158, datë 26.12.2019 "Për Sistemin e Taksave dhe Tarifave Vendore në Qytetin e Tiranës" me ndryshimet përkatëse.

Ky vërtetim lëshohet për efekt dokumentacioni.

III 1.11. Referuar ekstraktin të QKB-së së operatorit ekonomik “ADD Group” SHPK me NUIS L81722022V, rezulton se në “Ekstraktin historik i regjistrimit tregtar për të dhënat e subjektit shoqëri me përgjesi të kufizuar” janë pasqyruar ndryshimet si në vijim... Kanë ndodhur ndryshimet e mëposhtme në adresat e aktivitetit: **është Shtuar** Adresa: "Tiranë; Kamëz; Rruga "Bulevardi Nënë Tereza", Bashkia Kamëz, Nr pasurie 9/22 dhe ZK 2066; " **është Hequr** Adresa: Tirane ; Kashar; YZBERISH; Rruga "Spiro Flloqi", Pallatet "Ajazi", Kati i Parë, Nr.3, Njësia Administrative Kashar;. Ndryshime të cilat kanë ndodhur më datë 07.03.2024 kjo sipas ekstraktin historik në QKB.

Referuar dokumentacionit të ngarkuar në SPE operatori ekonomik “ADD group” shpk “Vërtetime për likuidimin e detyrimeve vendore”, ku këto të fundit i përkasin përkatësisht Adresës: "Tirane; Kashar; Yzberish; Rruga "Spiro Flloqi", Pallatet "Ajazi", Kati i Parë, Nr.3, Njësia Administrative Kashar; adresë e cila rezulton se është e ndryshuar nga operatori ekonomik referuar kjo ndryshimeve që ka bërë në ekstraktin e QKB-së ku kanë ndodhur ndryshimet e mëposhtme në adresat e aktivitetit: është shtuar Rruga Bulevardi NËNË Tereza Bashkia Kamëz me nr. pasurie 9/22 dhe ZK 2066.

Komisioni vlerëson se referuar verifikimeve në SPE si dhe verifikimit adresave të deklaruara në QKB që operon operatori ekonomik “ADD Group” shpk, duke qënë se në cilësinë autoritet kontraktor në këtë rast vetë Bashkia Kamëz, vlerësojmë që autoriteti kontraktor të verifikojë nëse janë shlyer detyrimet e taksave vendore duke marrë shkas kjo e fundit nga vetë politikat e brendëshme të menaxhimit institucional për shlyerjen e detyrimeve taksave vendore.

Për sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron pjesërisht.

III.1.12. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Erisony Company ” shpk me arsyetimin se: *...Në kriteret e vecanta te kualifikimit pika 2.2.3 enti prokurues ka vendosur kriterin kualifikues si me poshte: Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë për periudhën e garancisë së artikujve (jo më pak se 1 vit), gjatë së cilës ofertuesi do të sigurojë riparimin dhe mirëmbajtjen e tyre*”, Komisioni vëren se, referuar verifikimeve të dokumentacionit të ngarkuar në SPE nga operatori ekonomik “ADD Group” shpk rezulton se ka ngarkuar Deklaratën e Garancisë me të dhënat si në vijim:

Tirane me, 04/11/2024

Deklaratë Garancie

ADD GROUP shpk, pjesëmarrës në procedurën e prokurimit publik, që do të zhvillohet në datë **04.11.2024** nga Autoriteti Kontraktor **Bashkia Kamez**, me objekt “**Loti II-te: Blerje printera**”, me Nr. REF-24856-10-16-2024 dhe fond limit **1.020.317,00 (Një milion e njëzet mijë e treqind e shtatëmbëdhjetë) Pa tvsh.**

Unë i nënshkruari **Adenis Kastrati**, më cilësinë e administratorit të shoqërisë ADD GROUP shpk deklaron se:

Artikujt e kërkuara do të jenë sipas preventivit, dhe do të kenë garanci jo më pak se një vit nga momenti i furnizimit. Ofrojmë riparimin dhe mirëmbajtjen e tyre.

Data e dorëzimit të deklaratës

04/11/2024

III.1.13. Komisioni vlerëson se operatori ekonomik “ADD Group” shpk e përmbush kriterin e kërkuar në DST ku sipas të cilit: Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë për periudhën e garancisë së artikujve (jo më pak se 1 vit), gjatë së cilës ofertuesi do të sigurojë riparimin dhe mirëmbajtjen e tyre”, referuar kjo verifikimeve në SPE të dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik.

Për sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.1.14. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Erisony Company ” shpk me arsyetimin se: *“Pretendojmë se operatori ekonomik “ADD Group” shpk ka ofertuar pajisjet ,objekt prokurimi që nuk plotesojnë specifikimet e mësipërme të vendosura nga autoriteti kontraktor. Mendojmë që kataloget që ka dorëzuar ky operator nuk plotesojnë specifikimet e lartpërmendura. Pretendojmë që për pajisjen “**Fotokopje Multifunction High Volume Copy Machine**” e ka ofertuar pa finisher te jashtëm ,nuk ploteson ; Kapaciteti në Dalje Output Capacity min: 1000 Fletë, me Sorter me Stapler”*...Komisioni vëren se:

Autoriteti kontraktor ka kërkuar në kriterin e parashikuar në dokumentat standarte të tenderit për pajisjen “Fotokopje Multifunction High Volume Copy Machine”, rezulton se:

Fotokopje Multifunction High Volume Copy Machine

KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE	
“Model”:	Copier, Printer, Scanner
Shpejtësia “Copy/Print Speed for A4 ”:	≥ 55 ppm
Cikli Mujor i Punës “Monthly Duty Cycle”:	200 000 Faqe
Teknologjia “Technology”:	Laser Color
Zvogëlim/Zmadhim “Reduction/Enlargement”:	25%-400%
Vendosja e Dokumentit “Document Feeder”:	RADF/DADF
Sirtarët për Letrën “Paper Trays”:	4 (përfshirë Bypass-i)
Kapaciteti në Hyrje “Input Capacity min”:	2000 Fletë (jo Bypass-i)
Kapaciteti në Dalje “Output Capacity min:	1000 Fletë, me Sorter me Stapler

...

III.1.15. Komisioni, konstaton se referuar informacionit të ngarkuar në SPE si dhe referuar dokumentacionit të ardhur nga operatori ekonomik “ADD GROUP” SHPK rezulton se ka ngarkuar Katalog për printerat e cili rezulton se në përmbajtje të tij ka të evidentuar **Kapaciteti në Dalje “Output Capacity min”: 1000 Fletë, si më poshtë evidentuar me me të dhënat “Pika 1. 1000 Sheet Booklet (Finisher) optional providea three destinations for output including the ability to produce paginated saddle-stitched, punched and folded bookdets greally expanding yours in house capballities”**.

Për sa më sipër, referuar dokumentacionit të depozituar në SPE dhe pranë KPP-së Komisioni gjykon se, operatori ekonomik “Add group” SHPK e ka përmbushur kriterin për specifikimet teknike për pajisjen “Fotokopje Multifunction High Volume Copy Machine” me kapacitetin në dalje me output capacity min: 1000 letë , me sorter me stapler.

III.1.16. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Erisony Company ” shpk me arsyetimin se:... **dyshojmë** se OE “ADD Group” shpk nuk ka përmbushur nenin 26 të VKM 285 datë 19.05.2021 Rregullat e prokurimit publik në lidhje me kërkesën e AK për dorëzimin fizikisht në AK të dokumentacionit sipas formularit përmbledhës të vetëdeklarimit dhe dokumenteve të tjera shoqëruese të ofertës.....

Në ankesën drejtuar pranë autoritetit kontraktor dhe pranë KPP, operatori ekonomik ankimues nuk parashtron fakte apo dyshime të bazuara, por ngre pretendime a-priori, duke ngritur dyshime e hamendësime, lidhur me plotësimin e nenit 26 të VKM 285 datë 19.05.2021 nga operatori ekonomik “ADD Group” shpk, pjesëmarrëse në procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

III.1.17. Referuar Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton paraprakisht ankesën nga ana formale duke verifikuar (krahas juridiksionit administrativ dhe kompetencës lëndore, legjitimitetit të ankimuesit dhe respektimit afateve), edhe “elementet e domosdoshme të ankesës” sipas përcaktimeve të nenit 48, “Kushtet formale të ankesës”, pika 3: 25 - Ankesa, sipas rastit, mund të shoqërohet edhe me: a) provat dokumentare, të cilat ankimuesi kërkon të shqyrtohen nga Komisioni”.

III.1.18. Bazuar në sa më sipër, KPP gjykon se për të mbështetur pretendimet e tij, ankimuesi duhej të kishte shoqëruar ankesën e tij me prova, indicie dhe argumente ose dokumentacionin përkatës, në bazë të të cilave do të shqyrtohej kjo ankesë. Vlen të ritheksojmë se Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë administrativ, i cili në kuptim të nenit 90 të LPP dhe nenit 80 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, shqyrton ankesat mbi vendimet e marra nga KVO e autoritetit kontraktor, por ligjvënësi qartazi i ka ndarë detyrat dhe kompetencat e këtyre dy organeve. Pra, KPP nuk mund të marrë tagrin e KVO-së dhe të rivlerësojë në themel procedurën e prokurimit publik.

III.1.19. Operatori ekonomik ka detyrimin që ta bëjë të identifikueshëm pretendimin e tij mbi shkeljen e pretenduar, pra të evidentojë qartë dhe saktë se ku e bazon pretendimin e tij për mospërmbushjen e kriterit/kriterëve nga ana e operatorëve të tjerë ekonomikë. Theksojmë se mospërmbushja e kriterit apo kushteve të vendosura nga autoriteti kontraktor mund të vijë për shkaqe të ndryshme, siç janë mosparaqitja e një dokumenti të kërkuar, ose problematika që mund të prekin dokumentin etj. Është barrë e operatorit ekonomik që të përcaktojë se në cilin fakt apo rrethanë e mbështet pretendimin e tij për mospërmbushje kriteri/kriteresh.

III.1.20. Komisioni i Prokurimit Publik thekson dallimin e qartë – në gjykimin e tij, ndërmjet një pretendimi të një operatori ekonomik që ngre shqetësim mbi vlerësimin hipotetikusht të gabuar të ofertës së vetë atij nga ana e autoritetit kontraktor, nga njëra anë dhe, pretendimit/prendimeve të këtij operatori apo të cilitdo operatori pjesëmarrës në një procedurë prokurimi publik ndaj mënyrës së vlerësimit të autoritetit kontraktor për operatorët e tjerë konkurrentë në këtë procedurë, nga ana tjetër.

III.1.21. Në rastin e parë, kur interesi është absolut dhe i drejtpërdrejtë, barra e provës për të argumentuar shkeljet e pretenduara të autoritetit, ndonëse sërish qëndron mbi ankimuesin, në gjykimin e KPP është arsyeshmërisht më e lehtë. KPP e mirëkupton pozitën e operatorit dhe, në kuptim të misionit të tij për të siguruar efikasitetin e procedurave të prokurimit publik, përmes nxitjes së pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë, vlerëson se duhet të adoptojë një qëndrim pro-aktiv, në krah të operatorit ankimues. Në rastin e dytë, kur operatori pjesëmarrës në një procedurë ankohet në lidhje me ofertat e operatorëve konkurrentë, pesha specifike e barrës për të provuar paligjshmërinë hipotetike të këtyre të fundit është e plotë dhe qëndron mbi kurrrizin e pretenduesit, ndërkohë që KPP adapton një pozicion re-aktiv, në pritje të argumenteve të plotë provues se përse vlerësimi i autoritetit kontraktor ka qenë i gabuar, sipas ankimuesit. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se është në drejtë të operatorëve ekonomikë të paraqesin pretendime mbi kundërshtimin e vendimit të autoritetit kontraktor për kualifikimin e ofertës së operatorëve të tjerë ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, duke justifikuar kështu interesin e tyre të ligjshëm, por ndërkohë, operatorët ekonomikë nuk mund të parashtrojnë pretendime a-priori duke mos identifikuar asnjë element konkret brenda kriterëve të veçanta të kualifikimit, si edhe duke mos dhënë asnjë provë apo argument se ku mbështet pretendimet e tij. 26 Vetë Kodi i Procedurave Administrative ka parashikuar në nenin 82 pika 1 të tij se “Në procedurat administrative, të filluara me kërkesë të palës që inicion procedurën, barra e provës për faktet e pretenduara bie mbi këtë palë, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj Një ndër parimet kryesore të së drejtës është ai se “*onus probandi incumbit actori*” se barra e provës bie mbi ankuesin. Gjithashtu, KPP gjykon se kuadri ligjor në fuqi ka parashikuar të gjitha elementet procedurale, përmes të cilave garantohet e drejta e informimit të operatorëve ekonomikë në kuadër të zhvillimit të procedurave të prokurimit publik.

III.1.22. Një ankim në total, pa argumente të arsyeshme apo indicie të qarta, mbi të gjithë apo shumicën e elementeve përbërëse të ofertës së konkurrentit/konkurrentëve të kualifikuar përpara tij ose të barabartë me të në ofertë ekonomike, do të konsiderohet abuziv, në kundërshtim me qëllimin e veprimtarisë së Komisionit, pasi cenon efikasitetin dhe shpejtësinë e procedurës së prokurimit publik dhe nuk do të merret në shqyrtim nga KPP.

III.1.23. KPP është paraparë nga ligji si një quasi gjykatë. Si e tillë në vendimmarrjen e tij, Komisioni i Prokurimit Publik zbaton parimet kryesore të së drejtës. Një prej tyre është edhe parimi juridik i cili thekson faktin, se gjykata vendos në bazë të akuzave (pretendimeve) dhe provave. Komisioni i Prokurimit Publik refuzon të vendoset në pozitën e avokatit të ankimuesit e të investohet mbi një pretendim i cili nuk mbështetet në argumenta , por vetëm mbi pretendime hipotetike e dyshime të paarsyeshme.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk merret në shqyrtim.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një

procedurë ankimimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

procedurë ankimimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Erisoni Company” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur e thjeshtuar” me nr. Loti II-të: Blerje printera, me objekt: “Loti II-të: Blerje printera”, me fond limit: 1,020,317.00 Lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 04.11.2024 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kamëz.
 2. Autoriteti kontraktor të rivlersojë ofertën e operatorit ekonomik “Add group” SHPK sipas konstatimeve të vendimit të Komisionin e Prokurimit Publik .
 3. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
 4. Ngarkohet zyra e financës, të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Erisoni Company” shpk .
 3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Gjergj Mersini

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaïd Myzyri